

Prizren: Qëllohet një person me armë zjarri në të dy këmbët, i dyshuari arratiset



20/11/2025 09:42

f

t

l

Një 28-vjeçar ka mbetur i plagosur në të dyja këmbët mbrëmjen e së mërkurës në rrugën rrugën “Ismail Kryeziu” në Prizren.


Rastin për lajmi.net, e ka konfirmuar zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Prizrenit, Shaqir Bytyqi.

Bytyqi ka thënë se viktimë ka pësuar plagosje në të dy këmbët dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetë.

“Më datë 19.11.2025, rreth orës 23:15, në rrugën “Ismail Kryeziu” në Prizren, patrulla policore gjatë patrullimit ka dëgjuar krisma armësh dhe ka hasur një person të plagosur nga arma e zjarrit. Viktimë, Gj. Sh., mashkull 28 vjeçar nga Prizreni, ka pësuar plagosje në të dy këmbët dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetë. Sipas informacioneve të para dyshohet se viktimë ishte në lëvizje me automjet kur një person ka shtënë me armë në drejtim të tij dhe më pas është larguar nga vendi i ngjarjes me një trotinet elektrik. Viktimë është dërguar në Spitalin Rajonal të Prizrenit për trajtim mjekësor. Në konsultim me prokurorin, është filluar rasti “Vrasje në tentativë” dhe hetimet po zhvillohen nga Sektori Rajonal i Hetimeve i DRP Prizren”, ka deklaruar Bytyqi.

Ndërkaq Policia ka mbledhur prova nga vendi i ngjarjes, ka intervistuar viktimën dhe dëshmitarët, dhe po punon në identifikimin dhe arrestimin e të dyshuarit. [/Lajmi.net/](#)

LAJME TË FUNDIT

- 

“Gotat Nalt” prej Majkut, Kreshës dhe Gjikos –...
- 

Ambasadori britanik pret që partitë me bashkëpunim t'i...
- 

Orari i saktë i ndeshjes së Kosovës kundër...
- 

Gjykata Supreme udhëzon rinumërim në disa vendvotime në...

Artikuj të ngjashëm



November 20, 2025

Ambasadori britanik pret që partitë me bashkëpunim t'i formojnë institucionet pas...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information